

# ANALIZË KRITIKE E DISKURISIT TË MEDIAVE NË KOSOVË DHE SERBI

## PUNIMI I DOKTORATËS

Esin MUZBEG

### REZYME

Ky disertacion përqendrohet në debatet kritike të ideologjisë, diskursit dhe medias.

Ideologjitë e bëjnë më të lehtë kuptimin e botëkuptimeve. Pavarësisht nëse jemi të vetëdijshëm apo jo, ideologjitë janë në jetën tonë dhe nga njëra anë lehtësojnë perceptimin tonë për botën dhe nga ana tjetër na japin një botëkuptim. Nëse ideologjitë nuk do ta kishin këtë funksion, , bota do të ishte një vend më i rrëmujshtë, më kompleks dhe më pa kompromis. Në të njëjtën kohë, ideologjitë i shërbejnë edhe funksionit të mbulimit të realiteteve, imponimit të një botëkuptimi dhe parandalimit të zbulimit të marrëdhënieve dominuese. Pra është kuptimplotë të diskutohet ideologjia pa i dhënë asaj një domethënie pozitive ose negative. Prandaj sfida e parë e diskutuar në këtë disertacion ka të bëjë me ideologjinë.

Diskurset bartin ideologjitë. Ideologjitë i kodojnë vlerat e tyre dhe i transmetojnë ato përmes diskurseve. Diskurset kanë gjithashtu funksionin e lehtësimit të të kuptuarit të asaj që po ndodh përreth dhe (në vetë-shprehje) të kuptuarit në kontekste të ndryshme. Falë ekzistencës së diskurseve, komunikimi ndërmjet njerëzve (drejtpërdrejt ose indirekt) vendoset në mënyra praktike. Por diskurset gjithashtu transmetojnë ideologjitë, pikëpamjet dhe vlerat dominuese. Prandaj është kuptimplotë të analizohet diskursi në nivelin konceptual pa i dhënë atij një domethënie pozitive ose negative. Sfida e dytë në këtë disertacion lidhet me debatet mbi diskursin.

Media është mjete që përcjell ideologjitë përmes diskurseve. Ideologjitë i transmetojnë kodet e tyre të vlerave përmes diskurseve, por për këtë u duhen kanale dhe mjete të caktuara. Në shoqëri, ka shumë kanale për të komunikuar me masat dhe individët. Por kanali i përhapur dhe efektiv që na intereson është masmedia. Prandaj, media shërben si një mjet për transmetimin e kodeve ideologjike përmes diskurseve. Media është një institucion ku çdo qeveri dëshiron të ketë ndikim. Media vepron si një urë lidhëse midis qeverisë dhe popullit, duke monitoruar qeverinë në emër të popullit. Ky është një supozim i teorive të demokracisë liberale. Nga ana tjetër, teoritë kritike

thonë se media riprodhon ideologjitë dominuese duke argëtuar publikun. Debati i tretë i sfidës ka të bëjë me median.

Lajmet janë formate të transmetimit që ofrojnë informacion të paanshëm dhe objektiv në media. Megjithatë, pretendimet e tyre për paanshmëri dhe objektivitet janë ideologjike, siç diskutojmë në këtë disertacion. Manipulimet ideologjike, të cilat janë më të dukshme në përmbajtjet e tjera mediatike, në lajme janë të nënkuptuara me pretendimin se 'po përcjellim të vërtetën'. Megjithatë, manipulimet mund të shihen. Analiza kritike e diskursit është një qasje teorike dhe praktikë metodologjike që mundëson të shihen manipulimet në lajme. Analiza kritike e diskursit na mundëson të shohim marrëdhëniet e dominimit në tekste (të shkruara, vizuale, audio) si rezultat i analizës së tij në makro dhe mikro nivele.

Është e rëndësishme të shohim ideologjinë, diskursin, median (dhe lajmet si pjesë të saj), botëkuptimin që ndërton dhe përcjell dhe luftërat për dominim. Kjo është e mundur vetëm me një qasje kritike dhe një vështrim kritik.

Prandaj, krahas zhvillimit të të menduarit kritik, formimit të vetëdijes qytetare aktive dhe përhapjes së edukimit kritik për media rekomandohet edhe zhvillimi i edukimit kritik për ideologji.

Për të konkretizuar dhe vërtetuar çështjet e diskutuara në këtë disertacion janë analizuar mediat në Kosovë dhe Serbi. Duke i analizuar lajmet në nga dy gazeta nga secili vend dhe televizione publike në të dy vendet, analizohen ideologjia dhe diskurset e krijuara. Diskursi i miqësisë që ka zhvilluar Kosova me bashkësinë ndërkombëtare dhe çështjet që lidhen me të, marrëdhëniet bilaterale, çështjet e brendshme politike, qasjet e ekonomisë politike diskutohen në korpusin ideologjik dhe diskursiv të të dy vende.

Si rezultat, mediat në Kosovë dhe Serbi pavarësisht se ndajnë ideologji të ngjashme, janë gjetur të prodhojnë diskurse të ndryshme për shkak të vlerave të ndryshme dhe botëkuptimeve të ndryshme. Përveç dallimeve të dukshme diskursive midis dy vendeve, gjithashtu është vërejtur se media të ndryshme në një vend ndërtojnë rrëfime të ndryshme për të njëjtën çështje. Kjo tregon se mund të ketë po aq rrëfime sa ka edhe media. Prandaj, pyetja e mëposhtme merr më shumë rëndësi dhe kuptim: Cili rrëfim në media është i vërtetë dhe real?

Diskutimi në këtë disertacion nuk pretendon të gjejë të vërtetën dhe realitetin absolut. Por sugjeron se të vërtetat dhe faktet e paraqitura janë të dyshimta. Për këtë qëllim, mendimi kritik, mediat

alternative dhe edukimi kritik për media diskutohen në kuadër të ideologjisë, medias dhe diskursit dhe listës së rekomandimeve i shtohet edhe nevoja e edukimit kritik për ideologjinë.

Për studimin e rastit janë zgjedhur shtetet e Kosovës dhe Serbisë dhe mediat në këto vende. Për të konkretizuar, mediumet janë të kufizuara dhe të fokusuara në një kohë të caktuar. Megjithatë, shtrirja e temës dhe e hulumtimit nuk kufizohet vetëm në këto vende dhe media. Modeli i kërkimit të aplikuar mund të aplikohet në çdo vend dhe për kanale të ndryshme mediatike. Këtu nuk bëhet fjalë për vendet dhe qëndrimet e tyre ideologjike, por për ideologjinë, diskursin, median dhe diskutimet kritike për to.

**Fjalët kyçe:** Ideologji, Diskurs, Media, Lajme, Analizë kritike e diskursit, Kosovë, Serbi.

## ABSTRACT

This thesis revolves around ideology, discourse, media, and their critical debates.

Ideologies make it easier to make sense of worldviews. Whether we realize it or not, ideologies are in our lives and facilitate our perception of the world on the one hand and give us a worldview on the other. If ideologies did not have this function, the world would be a messier, more complex and more uncompromising place. But at the same time, ideologies also serve the function of obscuring pure facts, imposing a worldview and preventing dominant relations from being seen. It is therefore meaningful to discuss ideology without attributing a positive or negative meaning to it. The first challenge discussed in this thesis therefore concerns ideology.

Discourses convey ideologies. Ideologies encode their values and transmit them through discourses. Discourses also have the function of facilitating understanding of what is going on around and being understood (in self-expression) in various contexts. Thanks to the existence of discourses, communication between people (directly or indirectly) is established in practical manner. But discourses also transmit dominant ideologies, views, and values. It is therefore meaningful to analyze discourse at the conceptual level without attributing a positive or negative meaning to it. The second challenge in this thesis is related to debates on discourse.

Media is the tool that conveys ideologies through discourses. Ideologies transmit their value codes through discourses, but for this they need certain channels and tools. In society, there are many channels to communicate with the masses and individuals. But the widespread and effective channel that we are interested in is the mass media. Therefore, the media serves as a tool for the transmission of ideological codes through discourses. Therefore, the media is an institution that every government wants to have an impact on. The media acts as a bridge between the government and the people, monitoring the government on behalf of the people. This is an assumption of liberal theories of democracy. On the other hand, critical theories, say that the media reproduces dominant ideologies by entertaining the public. The third challenge debate concerns the media.

News are broadcast formats that offer impartial and objective information in the mass media. However, their claims of impartiality and objectivity are ideological, as we discuss in this thesis. Ideological manipulations, which are more obvious in other media content, are implicit in news with the claim that 'we are conveying the truth'. But they can still be seen. Critical discourse

analysis is a theoretical approach and methodological practice that allows the manipulations in the news to be seen. Critical discourse analysis enables us to see the relations of domination in texts (written, visual, audio) as a result of its analysis at macro and micro levels.

It is important to see the ideology, discourse, media (and news as a part of it), the worldview it constructs and conveys, and the struggles for domination. This is only possible with a critical approach. Therefore, in addition to the development of critical thinking, the formation of an active citizenship consciousness, and the dissemination of media literacy, and critical literacy of ideology is also recommended.

In order to concretize and prove the issues discussed in this thesis, the media in Kosovo and Serbia are analyzed. By analyzing the news in four newspapers and public television in the two countries, the established ideology and discourses are analyzed. The discourse of friendship that Kosovo has developed with the international community and the issues connected to it, bilateral relations, domestic political issues, political economy approaches are discussed in the ideological and discursive corpus of the two sides.

As a result, despite sharing similar ideologies, the media in Kosovo and Serbia have been found to produce different discourses due to different values and different worldviews. In addition to the obvious discursive differences between the two countries, it was also observed that different media in one country construct different narratives about the same issue. This shows that there can be as many narratives as there are media outlets. Therefore, the following question gains more importance and meaning: Which narrative in the media is true and real?

The discussion in this thesis does not claim to find the absolute truth and reality. But it strongly suggests that the truths and facts presented are questionable. To this end, critical thinking, alternative media and media literacy are discussed around ideology, media and discourse, and critical ideology literacy is added to the list of recommendations.

For the case study, the countries of Kosovo and Serbia and the media in these countries were chosen. In order to concretize, the mediums are limited and focused on a specific time. However, the scope of the topic and the research is not limited to these countries and media. The applied research model can be applied in any country and for various media channels. It is not about

countries and their ideological positions, but about ideology, discourse, media and critical discussions on them.

**Keywords:** Ideology, Discourse, Media, News, Critical Discourse Analysis, Kosovo, Serbia.